



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, 12.6.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 12.6.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

Komisioneri Publik në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese ka ankimuar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit vendimin nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Me anë të këtij vendimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përfundim të procedurave rivlerësuese mbi të tria kriteret, ka konkluduar në konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, magjistrate/gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë, pasi ka vlerësuar provat dhe faktet e administruara nga hetimit administrativ i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konstaton se ky hetim nuk është i plotë dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 4, nenin 45-55 dhe nenin 66, të ligjit nr. 84/2016, në vijim paraqesim shkaqet e ankimit dhe nevojën e hetimit të mëtejshëm nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të.

**I. VLERËSIMI DHE KËRKIMET E KOMISIONERIT PUBLIK**

**A. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë**

Në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë “Vetting” (më datë 24.1.2017). Referuar nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi i deklaratës “Vetting”, me përmbajtjen e deklaratave periodike të pasurisë, të dorëzuara nga subjekti, ndër të tjera, rezulton se:

**Në deklaratën “Vetting”,** subjekti ka deklaruar: - Apartament banimi, me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: rr. “\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë, krijuar në vitin 2006, në vlerën 6.000.000 lekë, i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, i banueshëm në vitin 2008.

**Burimi i krijimit:** “Kredia bankare në vlerën 5.000.000 lekë, e provuar me kontratën e kredisë bankare nr.\*\*\* datë.\*\*\*.12.2005. Diferenca në shumën e blerjes së apartamentit prej 1.000.000 lekë, krijuar nga kursimet ndër vite: (i) prej pagës si pedagoge (vitet 1995-1998); (ii) kursime nga bursa në vlerën 4.480.000 lireta/ITA nga MAE (Itali/1999); (iii) paga si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan (1998-2004); si dhe (iv) paga si gjyqtare në Gjykatën për Krimet e Rënda (2004-2006)”.

**Në deklaratën vjetore të vitit 2006 (DV-2006)** (dorëzuar më datë \*\*\*.3.2007), për këtë pasuri subjekti ka referuar si titull posedimi kontratën e sipërmarrjes/porosisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2006, me vlerë 6.000.000 lekë dhe pjesë zotëruese 100%. Kjo kontratë është lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e porositësit.

**Burimi i krijimit:** “Kredi bankare pranë \*\*\* Bank, në shumën 5.000.000 lekë... kredi me qëllim për blerje banese...”.<sup>1</sup>

Nga hetimi administrativ, lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2005, si pjesë të dokumentacionit për përfitimim e kredisë,<sup>2</sup> ka depozituar në bankë një tjetër kontratë sipërmarrjeje, atë me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2005, e ndryshme nga ajo e deklaruar në DV-2006.

Sipas kësaj kontrate, me palë shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, parashikohet se sipërmarrësi duhet të ndërtonte për porositësin një apartament me sip. 94 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 6.500.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, vlera prej 1.500.000 lekë i ishte paguar shoqërisë nga subjekti i rivlerësimit, përpara redaktimit dhe nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale, ndërsa 5.000.000 lekë do të paguheshin me anë të kredisë bankare.

Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit të komisionit, ka shpjeguar<sup>3</sup> se kjo kontratë sipërmarrje nuk është realizuar dhe se palët janë kthyer në gjendjen fillestare, duke pretenduar se shuma 1.500.000 lekë, e paguar prej saj, i është kthyer plotësisht nga shoqëria sipërmarrëse. Për këto veprime, juridike dhe financiare, gjatë hetimit administrativ nuk janë administruar akte provuese.

Nisur nga përmbajtja e deklarimeve vjetore, konstatohet se subjekti i rivlerësimit shumën 1.500.000 lekë<sup>4</sup>, paguar *cash*, në dhjetor 2005, nuk e ka deklaruar si kursime në DV 2003-2005.

Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, mbi pyetjen e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë: “...është pjesë e të ardhurave të kursyera nga prindërit, nga kontributet e mia nga pagat”.

Sipas parashtrimeve të subjektit, shuma e qarkulluar në dhjetor të 2005-ës (1.500.000 lekë) është e njëjta me shumën 1.000.000 lekë, e përdorur në shtator të 2006-ës, për të plotësuar vlerën 6.000.000 lekë, pas marrjes së kredisë, që ka shërbyer si e ardhur për blerjen (porosinë)

---

<sup>1</sup> Kjo kontratë kredie është nënshkruar mes palëve, në mbështetje dhe në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet \*\*\* dhe Ministrisë së Financave, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2005, për trajtimin me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit.

<sup>2</sup> Referohuni të dhënave në fashikullin Bankat, në dosje të Komisionit.

<sup>3</sup> Referuar përgjigjeve të subjektit dhe f. 7 të vendimit, mosrealizimi i kontratës ka ardhur jo për shkak të kushtit, pra mosçelja e kredisë sipas nenit 9 të kontratës së sipërmarrjes, por për arsye të pretenduar nga subjekti se nuk ishte gjetur gjuha e përbashkët dhe dyshimit të saj se apartamenti i porositur mund të ishte në kushtet që ligjërisht nuk ekzistonte, pasi sipërmarrësi nuk kishte respektuar volumin ndërtimor të përcaktuar në lejen e ndërtimit.

<sup>4</sup> Nga të cilat shumën 1.000.000 lekë, subjekti e ka deklaruar si diferencë për blerjen e pasurisë nr.1, nga kontrata e dytë e sipërmarrjes, paguar në \*\*\*.9.2006.

e apartamentit. Këtë shumë, subjekti pretendon ta ketë marrë nga babai i saj, duke evidentuar si burim edhe një depozitë në emër të ti, z. \*\*\*.\*\*\*.

Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se pranë bankës “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”, në emër të atit të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, ekziston një depozitë bankare në shumën 1.900.000 lekë. Kjo depozitë është hapur fillimisht në datë \*\*\*.10.2003, në bono thesari, në shumën 2.000.000 lekë, pranë Bankës së Shqipërisë<sup>5</sup>.

Nga kjo depozitë, z. \*\*\*.\*\*\*, në datën e lidhjes së kontratës së dytë të sipërmarrjes, datë \*\*\*.9.2006, ka tërhequr shumën 600.000 lekë. Sipas parashtrimeve të vetë subjektit<sup>6</sup>, kjo shumë së bashku me shumën prej 400.000 lekë, marrë *cash* sërish prej të atit, ka shërbyer për plotësimin e diferencës midis çmimit të plotë të apartamentit dhe kredisë së marrë pranë \*\*\*, gjithsej 1.000.000 lekë.

Nga analiza financiare për vitin 2006, Komisionit i ka rezultuar se: **(i)** subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri financiare të mbulimit të pasurisë së blerë dhe shpenzimeve të kryera me burimet financiare, të deklaruara në shumën 1.847.164 lekë; **(ii)** subjekti ka mungesë dokumentacioni provues lidhur me mundësinë e krijimit të kursimeve nga prindërit, realizuar nga kontributi i pagave të subjektit, shkaqe për të cilat, bazuar në nenin D, paragrafi 5 i aneksit të Kushtetutës, subjekti i ka kaluar barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën.

Konstatohet se Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, referuar pikës 1.14, f. 9 të vendimit, si dhe analizës përkatëse për vitin 2006, rezulton se në zërin e të ardhurave të ligjshme të subjektit ka përfshirë edhe kursimet e prindërve të subjektit ndër vite, pa hetuar mbi mundësinë e kursimit të tyre dhe ligjshmërinë e të ardhurave<sup>7</sup>.

Sa më sipër, konstatojmë se rrethana të tilla si: **(i)** regjimi i ekonomisë së përbashkët familjare, i pranuar nga vetë subjekti; **(ii)** kontrata e sipërmarrjes e dhjetorit 2005, sipas së cilës subjekti ka paguar shumën 1.500.000 lekë dhe pretendon ta ketë marrë mbrapsht atë; **(iii)** depozita me vlerë 1.900.000 lekë në emër të atit të subjektit, e cila pjesërisht ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë; **(iv)** vlera 400.000 lekë deklaruar e marrë *cash* nga i ati; **(v)** ekzistenca e llogarisë dyemërore të subjektit dhe babait të saj, janë verifikuar vetëm nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nuk janë deklaruar më parë nga subjekti.

Gjithashtu, nga aktet e administruara nga Komisioni, rezulton se deri në maj të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit dhe vëllain e saj.

Në kuadër të një analize financiare në lidhje me mundësitë e krijimit dhe ligjshmërisë së kursimeve dhe likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të, evidentojmë faktin se nga aktet e administruara rezulton se: **(i)** i ati i subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, nga data \*\*\*.4.1997, përfiton pension invaliditeti; **(ii)** e ëma, znj. \*\*\*.\*\*\*, përfiton të ardhura si arsimtare deri në vitin 2010, kur i ka lindur dhe e drejta për pensionin e pleqërisë, dhe **(iii)** i vëllai, z. \*\*\*.\*\*\*, nuk ka qenë në marrëdhënie pune deri më \*\*\*.12.2005.

**Komisioneri Publik** vlerëson se, për qëllim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës, neneve 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, faktet dhe rrethanat e mësipërme, si dhe vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme **për të cilësuar familjarët e subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, në kuptim të përkufizimit të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, qëndrim ky i mbajtur dhe në vendimin nr. 9/2018 (JR) të Kolegjit.**

<sup>5</sup> Referuar shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018, Banka e Shqipërisë.

<sup>6</sup> Mbi rezultatet e hetimit të Komisionit, protokolluar me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2018.

<sup>7</sup> Në analizën financiare të Komisionit gjenden të përfshira dhe shpenzimet jetike të subjektit në nivel individual për, periudhën 8/1995-12/2003, dhe ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi kursimi shumën 2.404.681 lekë. Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet familjare, ku eventualisht duhet të përfshiheshin dhe investimi i familjes në bono thesari në vitin 2003, në shumën 2.000.000 lekë, dhe blerja e automjetit në vitin 2000, në shumën 880.000 lekë.

Në vështrim të sa më sipër, këto rrethana janë të mjaftueshme që ato t'i nënshtrohen juridiksionit kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me qëllim **verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave të këtyre personave të tjerë të lidhur, të konstatuara, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, por të pahetuara prej këtij të fundit.**

Nevoja në përcaktimin drejt të gjendjes së fakteve, që kanë të bëjnë me kontrollin për burimin dhe ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të, në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, lidhet dhe me transaksionet bankare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*. \*\*\*.

Nga dokumentacioni bankar<sup>8</sup>, i administruar nga Komisioni, rezulton se, në datë \*\*\*.4.2005, janë kryer dy derdhje *cash*, përkatësisht 20.000 USD dhe 2.350 USD, total 22.350 USD, me përshkrim "*derdhje cash \*\*\*.\*\*\**", shuma këto të transferuara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit në një llogari bankare jashtë Shqipërisë<sup>9</sup>. Llogaria bankare është çelur në të njëjtën datë që është kryer transaksioni dhe është përdorur vetëm për këtë qëllim.

Kjo transfertë përkon me periudhën në të cilën subjekti vetëdeklaroi dhe pranoi që të ardhurat e saj administroheshin nën regjimin e përbashkët familjar, ku pjesëtarë figuron edhe i vëllai i saj, që në momentin e kryerjes së transaksionit nuk rezulton të ketë qenë në marrëdhënie pune ose biznesi.

## **II. Huaja e marrë nga i ati i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*. \*\*\***

Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se i ati i subjektit të rivlerësimit, me anë të kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2011, ka marrë hua, pa interes, shumën 7.000.000 lekë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me afat shlyerje datë \*\*\*.7.2021.

Sipas përmbajtjes së kontratës, huaja është lëvruar në dy këste, ku para lidhjes së kontratës pranohet nga palët kontraktore se janë dhënë *cash* 3.000.000 lekë dhe vlera e mbetur prej 4.000.000 lekë, janë kaluar nëpërmjet transfertës bankare në datën e lidhjes së kontratës, datë \*\*\*.7.2011.

**Komisioneri Publik**, në konsideratë edhe të vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se kjo marrëdhënie huaje **duhej të ishte parë si marrëdhënie pasurore e personit tjetër të lidhur, babait të subjektit të rivlerësimit, dhe si e tillë t'i nënshtrohej verifikimit të ligjshmërisë së burimit të saj**, për shkak se:

(i) Lëvrimi i kështit të parë prej 3.000.000 lekë, të kësaj huaje, pa interes, eventualisht është kryer, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit vijonte të ishte pjesë e ekonomisë familjare (shihni vendimin nr. 9/2018 (JR) të Kolegjit).

(ii) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore me faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit.

Gjatë hetimit të çështjes është konstatuar se i ati i subjektit të rivlerësimit, në gusht të vitit 2011 ka blerë bono thesari në Bankën e Shqipërisë, në shumën 4.000.000 lekë, si dhe në dhjetor të vitit 2011 ka blerë bono thesari, në shumën 3.270.000 lekë. Subjekti në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, sipas email-it, datë \*\*\*.2.2018, deklaroi se: "*... ligjshmëria e burimit të këtyre të ardhurave (në total 7.270.000) janë vlerë brenda shumës së kontratës së huamarrjes, cituar më lart. Pjesa tjetër e kësaj shume, prej 270.000 lekë, është interesi i tërhequr më datë \*\*\*.8.2011, nga bonot e thesarit të Bankës së Shqipërisë*".

Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, sipas email-it datë \*\*\*.3.2018, ka deklaruar se qëllimi i huamarrjes ka qenë blerja e një njësie shërbimi, pronë e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, por që nuk u realizua për shkak se trualli dhe njësia ishin vendosur si

<sup>8</sup> Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të bankës \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.

<sup>9</sup> Nga përshkrimi në *statement* rezulton se pagesa është kaluar në një llogari tjetër bankare jashtë vendit, nëpërmjet \*\*\* Bank.

garanci pasurore në favor të “\*\*\*.\*\*\*”. Subjekti deklaron gjithashtu se, gjatë periudhës 2012-2015, i ati ka shpenzuar nga huaja e marrë: “400.000 lekë për shpenzime administrative dhe rreth 1,000,050 lekë i ka shpenzuar në kohë dhe për arsye të ndryshme”, dhe shuma prej 5,600,000 lekë administrohet prej tij.

Referuar akteve të dorëzuara nga vetë subjekti, kontrata hipotekore nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ndaj pronës së \*\*\*.\*\*\*, daton prej \*\*\*.9.2007, fakt i cili tregon se palët në këtë marrëdhënie, në vitin 2011, kishin informacion mbi bllokimin e kësaj prone në favor të “\*\*\*.\*\*\*”.

(iii) Kushtet e parashikuara në këtë kontratë huaje paraqiten të natyrës atipike, pasi kjo shumë e konsiderueshme i jepet hua pa interes një personi me mundësi financiare të kufizuara për ta shlyer, si dhe duke e përdorur si burim fitimi, nëpërmjet investimit në bono thesari.

(iv) Nga aktet e administruara gjatë hetimit të Komisionit, rreth aktivitetit të huadhënësit, z. \*\*\*.\*\*\*<sup>10</sup>, ky shtetas është ortak në disa shoqëri, me pjesëmarrje në përqindje në kuota të ndryshme, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividend apo të ketë realizuar fitim deri në vitin 2011, nga pjesëmarrja në këto shoqëri.

### **III. Likuiditete të padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të**

Në vështrim të sa më sipër, trajtuam nga verifikimi i dokumentacionit bankar për subjektin e rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe DV vit pas viti, **për vitet 2003-2011**, konstatojmë se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat vjetore llogarinë në bono thesari, investuar nëpërmjet \*\*\* Bank, në vitet 2008, 2009 dhe 2010, në shumat përkatëse 300,000 lekë, 500,000 lekë dhe 700,000 lekë.
- Nuk ka deklaruar llogarinë dyemërore së bashku me të atin pranë \*\*\* Bank, në vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007, me gjendje përkatësisht sipas viteve në shumat 300,000 lekë; 412,712 lekë; 303,471 lekë dhe 303,795 lekë.
- Nuk ka deklaruar të ardhurat nga interesat bankare dhe gjendjen në llogarinë rrjedhëse në fund të çdo viti.
- Gjithashtu, personat e tjerë të lidhur kanë llogari në bono thesari, depozita bankare dhe rrjedhëse, për periudhën 2003-2011, detajuar në aneksin bashkëlidhur këtyre parashtrimeve.

### **IV. Çështje të tjera**

Si nevojë e hetimit dhe në kuadër të analizës financiare mbi burimin e ligjshëm të likuiditeteve dhe pasurive të subjektit të rivlerësimit, rezulton gjithashtu se Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2018, konfirmon faktin se i ati i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targë \*\*\*, sikurse dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi mjetin më targë \*\*\*, dalë nga qarkullimi në datë \*\*\*.7.2010.

Mjeti më targë \*\*\* është përdorur dhe poseduar gjatë periudhës që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për ta deklaruar, blerë nga i ati i saj, në vlerën 880.000 lekë, në vitin 2000, disponuar deri në vitin 2008. Subjekti i rivlerësimit ka pasur policë sigurimi, që ka mbuluar periudhat nga \*\*\*.4.2007 - \*\*\*.4.2008 dhe \*\*\*.4.2008 - \*\*\*.4.2009.

Nga hetimi administrativ, mbeten të paqarta arsyet e mosdeklarimit dhe mundësisë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të investuar në blerjen e këtij automjeti.

---

<sup>10</sup> Referuar shkresës së QKB-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2018.

## **V. Kërkimi i ankimit**

Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat dhe faktet e mësipërme janë përcaktuese në nevojën e një hetimi të plotë lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të, si detyrim nga neni D i aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, vetëm pasi të ketë kryer Kolegji **një hetim dhe vlerësim mbi burimin e ligjshëm, ligjshmërinë e të ardhurave dhe saktësinë e mjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë/likuiditetet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të**, në zbatim të nenit 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

ose

- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

## Aneksi 1

### Llogaritë bankare të padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2003 – 2011

Viti	Llogaria rrjedhëse e subjektit	Llogari bono thesari SR	Llogaria dyemërore SR ose i ati	Llogari depozite, i ati	Llogari bono thesari dhe kursime, i ati	Llogari rrjedhëse, nëna e subjektit	Interesa bankare të padeklaruara
2003	0		0	0	2,000,000	0	37,446
2004	0		300,000	353,364	1,900,000	0	184,688
2005	0		412,712	365,735	1,900,000	23,210	73,744
2006	268,958		303,471	1,100,000	0	130,725	637
2007	(24,874)		303,795	1,100,000	0	122,517	43,210
2008	80,239	300,000	0	1,100,000	0	197,810	41,760
2009	23,205	500,000	0	1,900,000	0	269,206	50,400
2010	126,158	700,000	0	2,000,000	0	45	107,400
2011	(22,633)	0	0	1,450,000	270,000	0	370,199
2011	Huaja e të atit nga shtetasi ***,***, investuar në bono thesari				7,000,000		